



DEBATA NACIONAL PËR POZITËN E SHTETIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Çka është anketa debatuese®?

Anketa debatuese® është një formë unike e konsultimeve politike e cila i kombinon teknikat e anketimit të opinionit publik dhe diskutimit publik. Ajo synon të paraqesë se si do të dukej opinionit publik për një temë të caktuar, nëse qytetarët do të kishin mundësi të njihen më shumë me temën. Anketa debatuese i pasqyron preferencat dhe opinionet e qytetarëve si para ashtu edhe pas njoftimit të detajuar me temën.

Mostra e të anketuarëve

Anketa fillestare

Para mbajtjes të anketës debatuese u realizua anketa e modelit reprezentativ prej 1001 të anketuarve nga i gjithë shteti në periudhën nga 27 maj deri më 14 qershor, 2024. Përkatësia etnike e të anketuarëve: 67% maqedon, 24,6% shqiptarë dhe 8,4% të tjerë.

Pas ngjarjes debatuese

Anketa debatuese u mbajt më 6 dhe 7 korrik 2024. Pas dy ditëve të ngjarjes ku 135 pjesëmarës u informuan dhe diskutuan me palët relevante në temën e caktuar, ata përsëri e plotësuan pyetësorin. Përkatësia etnike e të anketuarve që morën pjesë në ngjarje: 82,2% maqedon, 14,6% shqiptarë dhe 3,2% të tjerë.

Ngjarja debatuese


Ngjarja dy ditore u mbajt në Hotel Kontinental në Shkup më 6 dhe 7 korrik, 2024. 135 të anketuar të ndarë në 11 grupe u informuan dhe mësuan njëri tjetrin për politikën e jashtme të Maqedonisë së

Veriut dhe harmonizimin e saj me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian dhe për reportet e Maqedonisë së Veriut me NATO, duke u fokusuar në mehanizmat për siguri efektive, stabilitet ekonomik dhe mbrojtës. Më pas, secili prej grupeve i parashtrori pyetje panelit të përbërë nga ekspert dhe politikanë nga i gjithë spektri, me qëllim që të ndërtohen pikëpamje të informuara dhe të paanshme. Diskutimet e dy ditëve u transmetuan në TV 24 dhe TV Sitel.

Rezultate

Në vazhdim janë rezultatet e ndryshimit të qëndrimeve të qytetarëve pas debatit rreth pozitave të shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare.

1. Sipas mendimit tuaj, cilat janë përfitimet kryesore të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO?



① Si efekt i debatit, të dukshme janë rezultate statistikisht të rëndësishme me vlerë të shtuar pas debatit në përgjigjen e rritjes ekonomike. Një numër pjesëmarrësish rritën mbështetjen e tyre për rritjen ekonomike si përfitimi kryesor i anëtarësimit në BE dhe NATO pas debatit. Ka një rritje minimale në përqindje pas debatit në përgjigjen e rritjes së kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes. Nga ana tjetër, ka pasur rënie të përqindjes së pjesëmarrësve që besojnë se qasja në tregjet evropiane është përfitimi kryesor i anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO, para dhe pas debatit.

2. Në shkallë nga 0 në 10, ku 0 do të thotë aspak ndikim, 10 do të thotë shumë ndikim dhe 5 do të thotë një vlerë mesatare, a ndikon politika e jashtme e Maqedonisë së Veriut në jetën tuaj të përditshme?



European
Policy
Institute.
Skopje




NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Ndikon shumë



① *Debati ndryshoi ndjeshëm perceptimin e të anketuarve, duke rritur ndërgjegjësimin dhe perceptimin për ndikimin e politikës së jashtme në jetën e tyre të përditshme. Vlerat mesatare tregojnë një rritje të perceptimit nga 5.78 para debatit në 7.04 pas debatit. Sipas rezultateve, debati pati një ndikim domethënës dhe pozitiv në perceptimet e të anketuarve, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë dhe ndikimin e politikës së jashtme të Maqedonisë së Veriut në jetën e tyre të përditshme.*

Nuk ndikon
aspak



European
Policy
Institute.
Skopje




NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

3. Sa jeni dakord me pikëpamjet e mëposhtme lidhur me anëtarësimin e vendit në NATO?



European
Policy
Institute.
Skopje




NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

4. Me fjalët tuaja, më tregoni cila është politika e jashtme e një vendi? (përgjigje të shumta janë të mundshme)



Përgjigja e saktë: Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me vendet e tjera

① Një rritje e ndjeshme u vu re në ndërgjegjësimin e të anketuarve për rëndësinë e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me vendet e tjera, si dhe për të gjitha veprimet dhe hapat që një vend ndërmerr në raport me vendet dhe organizatat e tjera. Kjo tregon se debati ka ndikuar pozitivisht në kuptimin e domethënies të politikës së jashtme nga të anketuarit. Në të njëjtën kohë, ka një rënie në përqindjen e të anketuarve që shohin të gjitha aspektet e ofruara së bashku, gjë që sugjeron se të anketuarit kanë filluar të diferencojnë dhe vlerësojnë më shumë fusha specifike. Përveç kësaj, u shfaqën aspekte të reja të të menduarit, ndërsa një përqindje e vogël mbeti e pavendosur pas debatit.



European
Policy
Institute.
Skopje




NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

5. Në cilin vit Maqedonia e Veriut u bë zyrtarisht anëtare e plotë e NATO-s?



Përgjigja e saktë: viti 2020

① Pas debatit, përqindja e të anketuarve që identifikuan vitin 2020 si përgjigje e saktë për këtë pyetje u rrit ndjeshëm, duke arritur në 85,9% krahasuar me 56,7% para debatit. Vitet e mbetura (2019, 2021 dhe 2018) panë një rënie të rëndësishme midis të anketuarve, duke treguar se debati theksoi rëndësinë e ngjarjeve dhe ndryshimeve në vitin 2020. Përqindja e të anketuarve që nuk dinë ose refuzojnë të përgjigjen është ulur, duke sugjeruar ndërgjegjësim dhe qartësi më të mirë pas debatit.



European
Policy
Institute.
Skopje




NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

6. Në cilin vit filloi procesi i “screening” për anëtarësimin në Bashkimin Evropian?



Përgjigja e saktë: viti 2022

© Pas debatit, përqindja e të anketuarve që identifikuan vitin 2022 si përgjigje e saktë u rrit ndjeshëm nga 17.2% në 26.7%. Po kështu, ka një rritje për vitin 2021, nga 6.4% në 11.9%. Përqindja për vitin 2020 mbetet pothuajse e njëjtë. Ka një rënie të lehtë për vitin 2019, nga 36.9% në 33.3%. Ka një rënie të ndjeshme të përqindjes së të anketuarve që nuk dinë ose refuzojnë të përgjigjen, nga 29,3% në 17,8%, që tregon qartësi dhe ndërgjegjësim pas debatit.



European
Policy
Institute.
Skopje




NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

7. Sipas mendimit tuaj, nëse dhe si u reflektuan në vend sanksionet që ne si shtet zbatuam kundër Rusisë?



Përgjigja e saktë: Dobësimi i industrisë tekstile, farmaceutike dhe bujqësore

① Pas debatit, dukshëm është ulur përqindja e të anketuarve që besojnë se çmimi i energjisë elektrike është rritur (nga 71,1% në 54,1%) dhe se marrëdhëniet diplomatike me Rusinë janë ndërprerë (nga 43,7% në 34,8%). Është ulur edhe përqindja e atyre që besojnë se ka dobësim të industrisë së tekstilit dhe të bujqësisë, përkatësisht nga 31.1% në 16.3% dhe nga 38.5% në 23.7%. Përqindja e të anketuarve që besojnë se ka një dobësim të industrisë farmaceutike mbetet pothuajse e njëjtë, me një rritje të lehtë (nga 18.5% në 19.3%). Rritje të vogël ka edhe përqindja e të anketuarve që besojnë se rritja ekonomike e Maqedonisë së Veriut është rritur (nga 2,2% në 3,7%).



European
Policy
Institute.
Skopje



NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE




NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

8. Si i përballon Maqedonia e Veriut efektet e ndjera në ekonominë vendase për shkak të sanksioneve?

Përballet jashtëzakonisht mirë

Përballet jashtëzakonisht keq



① Ekziston një ndryshim statistikisht i rëndësishëm midis grupeve në opinionet se si Maqedonia e Veriut po përballlet me efektet në ekonominë vendase për shkak të sanksioneve. Kjo do të thotë se debati çoi në një përmirësim të ndjeshëm në perceptimet e të anketuarve se si Maqedonia e Veriut po merret me efektet në ekonominë vendase për shkak të sanksioneve. Vlera mesatare e përgjigjeve u rrit ndjeshëm nga 4.32 para debatit në 5.20 pas debatit, gjë që tregon se të anketuarit e perceptojnë situatën si më të mirë pas debatit.



European
Policy
Institute.
Skopje



NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD